



**RAMAZANI 1442,
DËSHMI NGAZËLLESE
E RINISË MUSLIMANE!**



NË KËTË DITË BAJRAMI...



**MESXHIDU'L-AKSAJA
OSE NË SHQIP
XHAMIA E AKSASË**

UDHA ISLAME

Viti 19 - Nr. 5 (219), Maj, 2021

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

*“Bajrami,
ç’kohë e këndshme, ç’kohë e gëzuar është!”*



MYFTIU: “BARAZIA NË ISLAM, DËSHMI E MADHËSHTISË SË FESË!”

Ajetet kuranore, ahadithet dhe praktika e sahabëve, mbeten pika referimi dhe reflektimi më i mirë i faktit se Islami erdhi edhe për të vendosur bazat e barazisë në mesin e njerëzve, shoqëruar me nxitjen e garimit për të mirë e ndërtim, mbështetur tek aftësitë, meritat dhe përkushtimi në jetë, jo tek pozitat shoqërore, pasuria a trashëgimia e emrit të familjes.

Fakti që Zoti i botëve na drejtohet në shumë vende në Kuran: “O ju njerëz...!”, na dëshmon se të gjithë jemi ,... (f. 9)



NJË PASDITE E BEGATË VLERASH BESIMI DHE VËLLAZËRIE ISLAME E KOMBËTARE

Sfidat dhe arritjet e muslimanëve shqiptarë në perëndim, ishin në fokusin e aktivitetit, që Myftinia Shkodër zhvilloi ditën e xhuma, më 21 maj 2021, në bahçen e xhamisë së Fushë Çelës.

Të ftuar për të sjellë eksperiencat dhe vizionet e tyre në këtë tubim, ishin edhe Imam Bekim Alimi, kryetar i Federatës Muslimane në Zvicrën Lindore, njëkohësisht imam dhe ligjërues në xhaminë e Wilit, si dhe Imam Didmar Faja, kryetar ... (f. 18)





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të dashur dhe të shtrenjtë, vëllezër dhe motra besimtarë!

Ditën e enjte, më 13 maj 2021, mbarë bota islame feston Fitër Bajramin!

Një ditë gëzimi dhe lutjesh për njëri-tjetrin, momente afrimi e pajtimi, çaste reflektimi dhe altruizmi, kohë për të ndihmuar e për të shtrirë dorën e mëshirës e bujarisë ndaj kujtdo që ka nevojë e që duhet të mos e ndjejë veten të braktisur e të harruar në Shqipërisë!

Ramazani që po kalon, ishte një muaj plot begati, kur të gjithë shijuar mirësitë e bujarinë hyjnore ndaj nesh; në veten tonë, në familje, në shoqëri e kudo. Ta ruajmë këtë frymë dhe ta mbajmë besën e Muajit Ramazan, edhe pas akshamit të kësaj dite, kur Hana e re e Muajit të Fitër Bajramit do të shfaqet horizonteve, për të lajmëruar hyrjen e atmosferës së Festës!

MESAZHI ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT 1442/2021

Fitër Bajrami është një ditë që na fton të jetojmë me gëzimin e besimin e Zotit në tokën tonë, në vendin tonë, në shoqërinë e familjen tonë. Ta falënderojmë Krijuesin tonë për çfarë na ka dhënë dhe të përpiqemi për të ndryshuar çfarë është prishur, sepse me besimin dhe fetarizmin tonë jemi të ftuar drejt ndërtimit!

Ramazani i sivjetshëm iu përgjak ymetit islam, por kjo nuk e theu as e frikësoi atë, përkundrazi, e forcoi edhe më shumë në rrugëtimet e pakthyeshme dhe qëndrimet e përbashkëta kundër dhunës e terrorit, kundër shkeljes së patolerueshme të drejtave themelore të njeriut, kundër krimeve dhe urrejtjes, të cilat e kanë prishur ekuilibrin e jetës në këtë botë!

Është momenti për të kuptuar se jeta merr vlerë, kur njeriu është i aftë të jetojë në harmoni me vëllanë e tij njeri, pa urrejtje, pa prerje në besë, pa smirë, pa tamah në pronën e shenjtëritë e tjetrit, pa paragjykime e pa egoizëm të sëmurë!

Fitër Bajrami është një ditë që na fton të jetojmë me gëzimin e besimin e Zotit në tokën tonë, në vendin tonë, në shoqërinë e familjen tonë. Ta falënderojmë Krijuesin tonë për çfarë na ka dhënë dhe të përpiqemi për të ndryshuar çfarë është prishur, sepse me besimin dhe fetarizmin tonë jemi të ftuar drejt ndërtimit!

Është momenti të mendojmë e të

punojmë me sa të kemi mundësi për të sotmen e fëmijëve tanë, për edukimin dhe arsimimin e tyre, për personalitetin dhe tiparet e besimit, për cilësitë dhe vlerat!

Gjatë viteve dhe dekadave të fundit, jemi befasuar nga shfaqje të frikshme të dhunës, krimi, shthurjes, korrupsionit e degradimit të individit dhe shoqërisë shqiptare, për të cilat nuk jemi razi dhe, për të cilat, elitat e shoqërisë duhet të gjejnë rrugët e bashkëpunimit për ta shpëtuar individin dhe shoqërinë nga kjo buzë greminë!

Besimi dhe vlerat e tij janë shpresa, prandaj le të kthehemi nga dyert e Zotit e të hapim zemrat para dritës së udhëzimit dhe rrezeve të tij!

Gëzoni me fëmijët e familjen tuaj, falënderojeni Allahun për mirësitë pa fund, me të cilat na begaton dhe punoni plot optimizëm për ditën që vjen, me bekime e mbarësi!

Gëzuar Fitër Bajramin!

Myftiu i juaj
Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 12 maj 2021

“

**Besimi dhe vlerat e tij janë shpresa,
prandaj le të kthehemi nga dyert
e Zotit e të hapim zemrat para dritës
së udhëzimit dhe rrezeve të tij!**

RAMAZANI 1442, DËSHMI NGAZËLLUESE E RINISË MUSLIMANE!

Ramazani i sivjetshëm, solli me vete një bekim shumë të madh për krejt ne, lirimin e kushteve të lëvizjes dhe tubimit, në kushtet e pandemisë, që u dëshmuar me dyndjen e rinisë nëpër xhami, duke dëshmuar një pamje të mrekullueshme të forcës së besimit dhe dritës së udhëzimit në zemrat e njerëzve.

Që nga nata e parë e teravisë, deri tek Nata e Kadrit dhe prej aty, deri në ceremonitë e Fitër Bajramit nëpër xhamitë e Shkodrës, ajo që dominoi ishte prania e rinisë në xhamitë tona.

U mbushën xhamitë për çdo të xhuma, ku të rinjtë e të rejtat zbukuruan shtëpitë e Zotit, tamam si gjelbërimi i harlisur i pranverës që i jep dritë e bukuri mahnitëse qyteteve dhe mjediseve tona!

Vajzat e reja me hixhab, përherë e më në dukje, po i shtojnë pashë e hijeshi qytetit të nanqve me degërmi të bardha e zemra flori, duke kthyer natyrshëm në vend ekuilibrat e prishur nga dekadat e para vitit 1990 e atë që e pasoi atë deri më sot!

Rinia e jonë po i kthehet xhamive dhe pyetja që duhet t'i bëjmë vetes është: A jemi ne të gatshëm për të punuar e rrugëtuar bashkarisht me të rinjtë e të rejtat tona, duke kontribuar që xhamia mos të ngelet për ta thjeshtë një objekt kulti i ftohtë, por një qendër e dashur, ku imamët bashkë me myftiun e tyre, janë aty për të ofruar atë çfarë nuk e

gjejnë jashtë xhamisë?

Me fjalë të tjera, prania e madhe e rinisë në xhamitë tona, falë bekimeve të Allahu për këtë shoqëri, mbi të gjitha është një sfidë për çdo myftini, myfti e imam, për të shkundur pluhurin e shërbimeve rutinë dhe për të qenë përherë e më aktivë në shërbim të rinisë sonë, duke gjetur rrugë e mënyra për t'ia bërë përherë e më tërheqëse, rehatuese e burim frymëzimi ardhjen dhe prezantimin në xhami!

Xhamitë e Shkodrës dhe kuadri i imamëve të saj e kanë mundësinë për të bërë përherë e më shumë në këtë drejtim, duke ecur në gjurmët e leximeve të ekuilibruara të biografsë së Resulullahut (a.s), sahabëve dhe brezave të shquar prej imamëve të mëdhenj reformatorë, dhe marrëdhënien e tyre me rininë!

Kam lexuar diku edhe këtë shprehje: “Rini pa ëndrra, si pranverë pa lule!”.

Koha është që rinia e jonë ta tejkalojë pragun e marrëdhënies formale me xhaminë drejt zhvillimit të aftësive dhe drejtimin e ambicieve (lexo: ëndrrave legjitime rinore) drejt shinave të lutjes kuranore: “neve na bën shembull për të devotshmit” – (Kurani, El-Furkan: 74)!

Koha është që imamët tanë të kuptojnë vlerën e madhe të pranisë së rinisë nëpër xhami dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit dorë për dorë për të krijuar brezin e ri të rinisë së dëshmuar në fjalët e

Resulullahut (a.s): “... dhe një i ri, i rritur me adhurimin e Allahut...” – (Buhariu, nga Ebu Hurejra), duke kontribuar përherë e më shumë për zgjerimin e konceptit të adhurimit të Allahut të Madhëruar në çdo fushë të jetës, jo vetëm në adhurimet e ditura në zanafillën e mësimave fillore të fesë!

Mbi të gjitha, jemi të ftuar bashkarisht të drejtojmë energjitë e rinisë sonë larg kaosit dhe anarshisë që shkaktojnë fetvatë e udhëzimet jovizionare, që e mbajnë peng atë, në rrethet e ngushta të debateve shterpë rreth lëvizjeve dhe mbështjellësve të çdo meseleje, larg thelbit dhe largpamësisë së çdo mesazhi e leximi fetar!

Falë Zotit, ky Ramazan theu krejt frikërat dhe pritshmëritë legjitime në përlloraritjet e realitetit të ri të xhamisë sonë, pas Ramazanit që kaloi...

Rinia e jonë theu tabutë dhe e mposhti frikën, paragjykimin, propagandën dhe presionin paradoksal për të qenë përherë e më frekuentuese e xhamisë e, përtej saj, për të dëshmuar moralin e besimit në jetë!

Është koha për t'u përqendruar përherë e më shumë tek të rinjtë e të rejtat tona, që Ramazani mos të ngelet thjeshtë një muaj folklorik në jetën e një viti në rutinë!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, 15 maj 2021





Hazir D. Selmani, Gostivar

MESXHIDU'L-AKSJA OSE NË SHQIP XHAMIA E AKSASË

që kishte një kapacitet për afër 1 mijë namazli. Pastaj ajo si godinë është rindërtuar dhe zgjeruar disa herë nga thuajse të gjitha dinastitë islame të mëvonshme. Në këtë xhami bëhet falja e pesë vakteve ditore me xhematë, ngase këtu ndodhet mihriabi i imami si dhe prej këtu mbahet edhe hytbeja e xhumasë.

2. Musala Mervani, ose në shqip Vendfaja Mervaniane. Është një ndërtesë nëntokësore me 16 hajate, e ndërtuar nga halifi emevit për të stabilizuar muret e rindërtuara të Xhamisë Kiblore. Në kohën e kryqëzatave ajo nga kryqëzatorët është përdorur si stallë kuajsh. Pastaj, pas rimarrjes Salahudin Ejubi e pastroi dhe e mbylli si ndërtesë. Ndërsa tani vonë vonë ka filluar të shfrytëzohet si xhami për nevojat e namazlive.

3. Musalaja e Vjetër e Aksasë, që ndodhet nën xhaminë kiblore. Në fillimet e ndërtimit të saj ky objekt ka shërbyer si rrugë e princërve emevit për hyrje-dalje nga pallati i tyre për në xhaminë kiblore. Deri vonë ka qenë e mbyllur për vizitorët, ndërsa me iniciativën e plakut të urtë Raid Salah ajo është rihapur si vendfajle.

4. Xhamia e Kupolës së Shkëmbit. Është ajo xhamia me kupolën ngjyrë ari dhe kjo llogaritet si një nga objektet më të bukur të Mesxhidu'l-Aksasë. Në kohën e kryqëzatorëve është përdorur si kishë dhe sipër shkëmbit të saj bënin fljimet e tyre. Shkëmbi i kësaj xhamie nga kryqëzatorët shitej me alltën. Pas çlirimit dhe rimarrjes Salahudin Ejubi e pastroi, e renovoi dhe e ktheu përsëri në xhami.

5. Xhamia e Burakut. Këtu thuhet se në Natën e Madhe të Israsë dhe Miraxhit ka qëndruar Buraku i Pejgamberit salallahu alejhi ve selem, kjo gjatë imamllëkut të Pejgamberit në namazin e falur me gjithë pejgamberlerët tjerë.

6. Xhamia e Magribinjëve (malikive). Kjo xhami është ndërtuar nga Salahudin Ejubi për myslimanët e medhhebit maliki, të cilët si zakonisht vinin nga magribi (perëndimi) i botës islame të asaj kohe.

7. Xhamia e grave. Këtë godinë fillimisht e kanë ndërtuar kryqtarët gjatë kohës kur Aksaja ishte nën pushtimin e tyre. Pastaj, Salahudin Ejubi pas rimarrjes së Aksasë atë e ktheu në xhami të grave.



Xhamia e Kupolës së Shkëmbit. Është ajo xhamia me kupolën ngjyrë ari dhe kjo llogaritet si një nga objektet më të bukur të Mesxhidu'l-Aksasë.

KONGRESISTJA E SHBA-SË: SULMET IZRAELITE NË GAZA, “AKT I TERRORIZMIT”

Washington

Sulmet ajrore të Izraelit në Rripin e Gazës që kanë rezultuar me të paktën 24 civilë të vranë, përfshirë nëntë fëmijë, “janë një akt terrorizmi”, ka thënë kongresistja amerikane Ilhan Omar, transmeton Anadolu Agency (AA).

“Palestinezët meritojnë mbrojtje. Ndryshe nga Izraeli që posedon mbrojtjen nga raketat, si Kupola e Hekurt, diçka e tillë nuk ekziston për të mbrojtur civilët palestinezë”, shkroi Omar në Twitter.

“Është e pandërgjegjshme të mos dënosh këto sulme në javën e Bajramit”, shtoi ajo.

Përveç të vranëve, Ministria palestineze e Shëndetësisë tha se mbi 100 persona u plagosën në sulmet ajrore.

Sulmet izraelite erdhën pasi grupet palestineze lëshuan rreth 100 raketa, përfshirë shtatë në Kudsi, ndërsa raketat e tjera shënjestruan qytetet Ashkelon, Sderot dhe vendbanimet pranë Rripit të Gazës.


Sulmet me raketa erdhën si përgjigje e sulmeve të vazhdueshme izraelite në Xhaminë Al-Aksa dhe debimit të



IZRAEL/PALESTINË

Dëbimi i palestinezëve

Në 1948, forcat militare zioniste dëbuan me forcë, të paktën **750.000 palestinezë dhe përvetësuan 78% të territorit historik të Palestinës**. Pjesa e mbetur, prej 22% u nda në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës.



familjeve palestineze nga lagjja me shumicë palestineze Sheikh Jarrah në Kudsin Lindor të okupuar.

Të paktën 305 persona u plagosën ndërsa policia izraelite sulmoi Al-Aksanë në Kudsin Lindor të okupuar dhe palestinezët që ishin duke bërë roje për të parandaluar sulmet e mundshme nga izraelitët hebrej të ekstremit të djathtë, sipas Gjysmëmehës së Kuqe Palestineze. Al-Aksa është vendi i tretë më i shenjtë në Islam.

Tensionet kanë qenë në rritje në Kudsin Lindor si pasojë dëbimeve të planifikuara të dhjetëra palestinezëve nga lagjja Sheikh Jarrah, e cila ndodhet në veri të Qytetit të Vjetër. Palestinezët, të cilët u ngritën në protesta solidariteti me banorët, janë vënë në shënjestër të forcave izraelite dhe grupeve të kolonëve izraelitë.

Izraeli pushtoi Kudsin Lindor gjatë luftës arabo-izraelite në vitin 1967 dhe aneksoi gjithë qytetin në 1980, një veprim i cili nuk është njohur kurrë nga komuniteti ndërkombëtar.

(www.aa.com.tr)

NË SHKODËR U FESTUA MË MADHËSHTI FITËR BAJRAMI

Më 13 maj 2021, megjithëse në situatë pandemie, mijëra besimtarë myslimanë në të gjitha xhamitë e Shkodrës zhvilluan ritualet e Fitër Bajramit, që është një nga festat më të mëdha të fesë islame.

Ceremonitë kryesore të kësaj feste u mbajtën në xhamitë "Ebu Bekër" dhe në xhaminë e Parrucës, për të vijuar më pas me faljen e namazit të Bajramit të Ramazanit.

Në Xhaminë "Ebu Bekër", Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari



"Ebu Bekër"



"DY VAJZAT"

bëri thirrje për mos largimin e të rinjve nga vendi. Ai uroj që në këtë festë të shenjtë besimtarët të manifestojnë bashkim, dashuri dhe falje, sikurse u lut për shpërblimin nga Zoti (xh.sh) për mirësi e paqe me veten dhe me të gjitha krijesat në tokë.

Pas faljes së namazit të Fitër Bajramit besimtarët vazhduan festimet në shtëpitë e tyre.

Vitet e kaluara falja e namazit të Bajramit është realizuar në sheshin vakëf, përbri Xhamisë së Madhe, por

edhe këtë vit për shkak të masave kundër përhapjes së koronavirusit, besimtarët e kanë falur namazin vetëm në xhami, duke respektuar masat e vendosura nga institucionet shtetërore kundër COVID-19.

Myftinia Shkodër uron të gjithë besimtarët: Me zemër të mirë Fitër Bajramin, Allahu i Madhëruar jua pastë pranuar agjërimin dhe të gjitha adhurimet!



BARDHAJ



GUCI E RE



MEDRESE

NË KËTË DITË BAJRAMI...

- Ese -



Xhahid Bushati, shkrimtar

Në këtë Ditë Bajrami, ditë planetare, kuptimplote, rrezellitëse, e hijshme, gëzimtare..., m'u kujtua poezia "Bajram" (f.137-140) të mendimtarit të madh turk me origjinë shqiptare Mehmed Akif Ersoj (Pejani). E kisha lexuar vite më parë tek libri monumental i titulluar "Fletët", Botues: Logos-A, Shkup, 2006. E lexova përsëri, e përsëri do ta lexoj... Mehmed Akif Ersoj është nga ajo tipologji poetësh që i përkasin monumentalitetit. Mendoj, që edhe poezia, e shkruar në monokolonë, me fraktura poetike që kanë dimensionin e hapësirave, në thelb, në strukturë e shtjellim i përket Monumentales.

Në vështrimet e mia dhe qasjes ndaj kësaj poezie, do të ndalem në disa aspekte, të cilat lidhen më kohën, si p.sh: - Përse kjo poezia nuk vjetërohet në kohë?, - Pse kjo poezi nuk mund të harrohet e pluhuroset në kohë?, -Përse kjo poezi mbetet aktuale, jetësore, shenjtëruese, gëzimsjellëse dhe ëndërruese?..

1. PORTRETI DHE MREKULLIA E FESTËS

- Përmendja e nocioneve dimensionale, si: Horizont, botë, etj. Mbeten një veçori e personalitetit

krijues të Ersojt. Autori thotë: "Horizonti i tërë qesh, bota tjetër botë;".

- Përmendja e Festës në raport me kohën, në raport me fëmijën si vazhdimësi jete e vazhdimësi drite, si: "Bajrami, ç'kohë e këndshme, ç'kohë e gëzuar është! / Në Bajram qesh fytyra e fëmijës së pafajshme, / në pamjen e dëlirë të fëmijës shpresa e qartë është! / Në çdo ballë një dritë e padukshme në shkëlqim, / Gjithëkohë në çdo sy një shpirt kah përsillet është!"

Veçori: përdorimi në fund të vargut të foljes është, mendoj se ka të bëjë me gjendjen e personazhit (në rastin tonë fëmija), gjithashtu me dritëshenjën, dritëshpresën, dritëardhmërinë, dritëbesimin.

2. Drita e Festës

Edhe në fragmentin e zgjedhur, elementi dimensional mbetet mjet komunikimi, por i lidhur me zemrën, shpirtin, njerëzoren dhe përjetësinë e moshës së rinisë. Ja, sesi shprehet poeti: "Çehren e tokës shih: sa e hareshme, sa rinore është! / Në çdo gjoks një zemër është kah rreh me hare, / Në çdo zemër, një botë pasionesh e fshehur është! ... O Zot, ky shpirt i shpërndarë gjithë botëve, ç'shpiet është?"

Veçori: shumë vargje mbartin funksion e ngjyrë dëshirore e pyetësore? Përkatesia e tyre na thonë se janë lejt motive dëshirash e begative që na sjellë Festa e Bajramit. Bajrami – një festë e bukur e dëshirave njerëzore!

Në këtë poezi, shpesh herë me nota himnizuese, siç e meriton Festa e Bajramit, autori kthehet në

fëmijërinë e tij, i qaset me detaje atij gëzimi (a gëzimesh) të paharruara e gjithmonë të mirëkujtuara. Sepse kujtimet që dritësojnë shumë pjesë nga krijimtaria e Ersojt, nga thëniet e studiuesve konkludohet se ata mbeten një kod i rëndësishëm dhe jetik.

Kjo poezi përkushtuese për Bajramin, e frymëzuar me madhësinë e penës së Ersojt, mbyllet me një kurorë, që në të vërtetë është prekëse dhe drithëruese. Pikërisht në këtë mikro-ngjarje madhështia e Bajramit, edhe asaj vogëlusheje jetime që qan ia fshin lotët dhe i fal si dritë shpirti: gëzimin e moshës, gëzimin e jetës, gëzimin që e meriton të jetë si gjithë të tjerët.

Citojmë:

"Qan një vajzë vetullhollë, e bukur e flokëgjatë!

Kush vjen e kush shkon, pyet: "Kjo vajzë pse qan?"

- Jetime, or ti, fëmija e fëmijës, dhimbje për këtë të ngratë!

Pse, a s'është fëmijë dhe ajo? "Lëkundëse" – thotë...

- O ti me lëkundësen, - të hip pak dhe kjo... Bëje një të mirë... Kush gëzon jetimin, jeton gjatë...

- Posi, posi, le të vijë!

Hipi jetimja në lëkundësen e njeriut bujar,

U bashkua dhe ajo me gëzimin e vajzave që nuk qajnë!"

Shkodër, më 13.05.2021

MYFTIU: “BARAZIA NË ISLAM, DËSHMI E MADHËSHTISË SË FESË!”

I ftuar në ciklin e bashkëbisedimeve me temë: “Kjo është ora”, që gazetari Armand Bora zhvillon çdo ditë Ramazani në RTV ORA, ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Temë e bashkëbisedimit të kësaj dite ishte: “Barazia në Islam”.

Në një postim tijin në fb, Myftiu shkruan:

Një bashkëbisedim i hapur në thelb të temës së barazisë në Islam, pasditen e së martës, më 4 maj 2021, me të nderuarin Armand Bora, në RTV ORA, në ciklin e Muajit të begatë të Ramazanit: “Kjo është ora”.



Ajetet kuranore, hadithet dhe praktika e sahabëve, mbeten pika referimi dhe reflektimi më i mirë i faktit se Islami erdhi edhe për të vendosur bazat e barazisë në mesin e njerëzve, shoqëruar me nxitjen e garimit për të mirë e ndërtim, mbështetur tek aftësitë, meritat dhe përkushtimi në jetë, jo tek pozitat shoqërore, pasuria a trashëgimia e emrit të familjes.

Fakti që Zoti i botëve na drejtohet në shumë vende në Kuran: “O ju njerëz..!”, na dëshmon se të gjithë jemi të barabartë përpara Tij, ndërsa me fjalinë e shenjtë: “Më fisniku prej jush tek Allahu është më i përkushtuari ndër ju!”, na mëson se rruga drejt bekimeve dhe pranimit tek Madhnia e Tij kalon nëpërmjet korrektësisë sonë në jetë me atë që Ai na ka udhëzuar, jo sukseseve të përkohshme a arritjeve tona materiale larg udhëzimit të Tij!

Fjalët me të cilat Resulullahu (a.s) iu drejtua të bijës së shtrenjtë Fatime dhe axhës së dashur Abasit, kur i tha secilit prej tyre që ta kenë frikë Allahun dhe të mos vijnë në ditën e gjykimit me emrin e Resulullahut, ndërkohë që njerëzit do të vijnë me veprat e tyre, është dëshmia më e madhe e barazisë dhe objektivitetit në trajtimin e njerëzve në peshoren islame.

Ndërkohë, shembulli i Hz. Omerit (r.a), që mori hakun e të krishterit kopt nga i biri i guvernatorit të Misirit, por edhe nga vetë guvernatori, sahabiu Amr ibnul-As (r.a), është dëshmi e pashembullt historike, jo vetmitare, e origjinalitetit të kësaj feje të pastër islame dhe mësimëve të saj universale në këtë kontekst!

Referuar kodit civil dhe atij penal, sipas shkollës sonë hanefite, pozitat e barabarta përballë ligjit, të muslimanëve dhe dhimitëve (të krishterë e hebrenj) në shoqërinë islame, mbeten një dëshmi universale e madhështisë së kësaj feje, në të cilën çdokujt i garantohet jeta, feja, mendimi, nderi dhe pasuria!

Pata kënaqësi të madhe të dëgjoj, të ftuar në studio në lidhje me skype, mikun dhe vëllain e shtrenjtë, Basri Kurtis, që e zbukuroi këtë bashkëbisedim me ndërhyrjen e tij nga Kopenhaga.

Marrëdhëniet e shtetit danez me liritë fetare, historiku i organizimit të muslimanëve shqiptarë

atje, aktiviteti në vazhdimësi, përkujdesja që mësimet dhe takimet të jenë në gjuhën tonë shqipe, si dhe shembulli i mrekullueshëm i bashkëpunimit me bashkësitë dhe komunitetet e tjera fetare, në shërbim të paqes sociale dhe vlerave qytetëruese, ishin disa prej rrezatimeve në komunikimin e ëmbël të imamit tonë të dashur në Danimarkë.

Kufiri i një ore, ishte i pamjaftueshëm për të shpjeguar logjikisht dhe fetarisht, mbi të gjitha mjaftueshëm se, përpjekja për të barazuar të ndryshmit në origjinën e krijimit, është prishje e ekuilibrit në natyrë, si dhe dëshmi e moskuptimit të faktit se Zoti na krijoi nga një mashkull dhe një femër, të cilët i veçoi me cilësi dhe tipare të ndryshme, përtej kufirit të barazisë, por edhe se, nuk është respektuar e vlerësuar pozita e femrës në të gjitha fazat e jetës së saj, si në Islam.

Është i jashtëzakonshëm qëndrimi i Resulullahut (a.s) me mbesën e vogël në xhami, shpejtimi i kryerjes së namazit për të mos trazuar nënën e foshnjes që qante, si dhe marrëdhënia e tij bashkëshortore, që duhen lexuar në një këndvështrim, që e tejkalon atë të barazisë së pakuptimtë gjinore.

ET-TAHIR IBN ASHUR, DIJETARI I VENDOSUR QË NUK IU SERVILOS PUSHTETARËVE...

Në vitin 1961/1381h, presidenti i Tunizisë, Habib Bourguiba u shfaq në televizion ditën e Ramazanit duke çelur agjërimin dhe duke i bërë thirrje njerëzve të mos agjërojnë.

Në mënyrë që kësaj pune t'i jepte ngjyrë fetare, kërkoi prej myftiut të Tunizisë së asaj kohe, e ai ishte kolosi Et-Tahir ibn Ashur (r.h), të japë fetva për lejimin e mos agjërimin me pretendimin e shtimit të prodhimit (rendimentit të punës)!!

Dijetari i nderuar, Et-Tahir ibn Ashur doli në televizionin tunizian, ndërkohë që njerëzit po prisnin me padurim, se çfarë do të thoshte Myftiu.

Dijetari filloi me leximin e ajetit të agjërimin: “O ju që keni besuar, agjërimi ju është bërë obligim, siç ka qenë obligim edhe për ata, të cilët ishin përpara jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm” - (Kur’ani, El-Bekare: 183).

Pastaj tha: Sadakallahu (Allahu ka thënë të vërtetën), ndërsa Bourguiba gënjen, sadakallahu, ndërsa Bourguiba gënjen, sadakallahu, ndërsa Bourguiba gënjen!

E përsëriti tre herë dhe dha fetva, që agjërimi të mos ndërpritet, se është haram dhe kushdo që vepron në një mënyrë të tillë, “ai ka mohuar diçka, që duhet ditur domosdoshmërisht nga feja”.

Ai hodhi poshtë pretendimin, se agjërimi sjell ulje të prodhimit dhe gojë të heshtën, ndërkohë qeveria tuniziane nuk arriti, vetëm se tërhiqej nga pretendimi i saj. Allahu e lartësoi obligimin e agjërimin në Tunizi nga dora e dijetarit të madh Et-Tahir ibn Ashur (r.h).

Dijetari i madh, myftiu i Tunizisë, Et-Tahir ibn Ashur nuk ishte prej atyre që i servilosej pushtetarëve dhe kishte krijuar një distancë mes tij dhe mes tyre, qëkur mori përsipër detyrën e myftiut. Ai nuk pranoi prej tyre asnjë dhurim apo dhënie. Ai ishte shembull, që duhet ndjekur nga dijetarët, të cilët i ndryshojnë fetvatë, duke iu përgjigjur epsheve dhe dëshirave të pushtetarëve dhe qeveritarëve, siç i shohim në ditët tona sot!

Sa të nevojshëm jemi për shembuj të tillë!

Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja

MUSLIMANËT ROJTARË TË VENDEVE TË SHENJTA TË KRISHTERIMIT

Vendet e Palestinës, që kujtojnë jetën e Isait (a.s) - Jezusit – që nga gjysma e shekullit të katërt, ishin bërë vende pelegrinazhi shumë të frekuentuara, të favorizuara nga marrëdhëniet e dendura me lindjen.

Edhe kur këto toka u morën nga arabët – muslimanët – për vendet e shenjta u vendosen rregulla të caktuara nga marrëveshjet midis kalifit të Bagdadit, Karlit të Madh dhe Patrikanës së Jeruzalemit – Kudsit - ¹

Rimarrja e Palestinës nga ana e myslimanëve, e rriti kujdesin e tyre për ruajtjen e Varrit të Shenjtë dhe vendeve të shenjta të Krishterimit. Vendet e shenjta në Palestinë, janë kisha në të cilat kanë ndodhur ngjarjet kryesore të jetës së Jezusit.

“Sipas të drejtës së luftës”, - shkruante Ubicini,- “Ata ishin zotër mbi këto monumente të shenjta për të krishterët, por nuk i shkatërruan. Ata i ruajtën, mbajtën rregullin, pastërtinë, e atë heshtje respektuese që bashkësitë e krishtera nuk dinin të mbanin ndërmjet tyre. Ata ruanin

1. Luigi Salvatorelli, Profilo Della Storia D'Europa, Torino 1942, f.325. Vendet e shenjta: Kisha e Shpalljes në Nazaret, Kisha në Betlehem, Kisha në Sikem, Kisha në të cilën Jezu Krishti – Isai (a.s) – ktheu ujën në verë, Kisha në Tiber-niede, Kisha e Prezantimit, Kisha e Apostujve, Kisha e Fshikullimave, Kisha e Varrit të Shenjtë, Kisha në Malin Oliveto, dy Kishat në Gastemani.

me xhelozitë reliket e përbashkëta të të gjitha sekteve kristiane, dhe secili nga këto mund të nderonte kultin e tij në Varrin e Shenjtë”. Nëse nuk do të ishin Turqit – Osmanët - , “këto monumente do të kishin qenë një mijë herë objekt lufte midis komuniteteve rivale e xhelozë. Është padrejtësi të akuzohen muslimanët ... Myslimani (...) midis të gjithëve, është i vetmi popull me të vërtetë tolerant”. Të pyesin veten kristianët , - theksonte Ubicini , - “Çfarë do të kishin bërë nëse fati i luftës do të ishte në anën e tyre dhe të kishin vendosur pushtetin mbi Mekën dhe Qaben: Do të vinin ndoshta muslimanët nga të gjitha anët e Evropës dhe Azisë për të nderuar me qetësi monumentet e ruajtura nga islamizmi?”²

Në 1849, abati Michon përshkoi Sirinë e Vendet e Shenjta. Në shkrimin e titulluar E vërteta rreth vendeve të shenjta, ekspozuar nga një që i njeh, theksonte se Islamizmi – Islami -, pas rimarrjes së Palestinës, kishte vënë në ruajtje të gjitha faltoret, që i adhuronte jo më pak se të krishterët. Politika e mençur e Osmanëve detyronte respekt për vendet e shenjta dhe çdo komb evropian ruajti të drejtën e pronësisë mbi monumentet publike të Palestinës dhe përdorimin e vendeve të shenjta. Me

2. Addalino Ubicini , Questione d'Oriente – Innanzi L'Europa , Un sguardo Addietro alla questione dei Luoghi Santi; Milano 1854 , f. 75-76.

këtë politikë, Osmanët vunë në praktikë tolerancën religjioze, Ubicini theksonte: “Nuk ka vend në botë ku të mbrohen, ku të gëzohet liria e ndërgjegjes më shumë se në Lindje: Ata kanë religjione të ndryshme, e të gjithë ushtrojnë lirisht kultin e tyre”.³

Abati Michon përshkruante edhe ruajtjen e Varrit të Shenjtë: “Pesë-gjashtë myslimanë, ulur mbi divan, bisedonin e tymosnin me pipat e tyre përreth kishës së Varrit të Shenjtë. Kur mbyllnin portat, kuptohet se u kishte ardhur ora për t'u falur”. Por, a i shqetësonte besimtarët e krishterë prania e myslimanëve në varrin e shenjtë?! Abatit i kishte bërë përshtypje përgjigja e tyre: Preferojmë turqit përpara grekëve! E grekët besoj unë, thonë: Preferojmë turqit përpara latinëve! Këto fjali të trishta i dëgjova shumë herë të përsëriteshin gjatë qëndrimit tim në Jerusalem – Kuds - ... Çfarë do të ishim ne, nëse nuk do të ishin Turqit? – më thonë vazhdimisht. Nuk di si t'u përgjigjesh këtyre fjalëve!”⁴

(Me përshtatje, nga libri: Midis Perandorive dhe Religjioneve Nga edikti i Kostandinit tek traktati i Berlinit, me autor Xhafer Sadiku, f. 151-152)

3. Po aty.
4. Po aty.

“ATA ISHIN ZOTËR MBI KËTO MONUMENTE TË SHENJTA PËR TË KRISHTERËT, POR NUK SHKATËRRUAN. ATA I RUAJTËN, MBAJTËN RREGULLIN, PASTËRTINË, E ATË HESHTJE RESPEKTUESE QË BASHKËSITË E KRISHTERA NUK DININ TË MBANIN NDËRMJET TYRE. ATA RUANIN ME XHELOZI RELIKET E PËRBASHKËTA TË TË QJITHA SEKTEVE KRISTIANE, DHE SECILI NGA KËTO MUND TË NDERONTE KULTIN E TIJ NË VARRIN E SHENJTË”.



MAURITANIA OSE REPUBLIKA ISLAME E MAURITANISË

Mauritania, ose Republika Islame e Mauritanisë, është një shtet arab dhe afrikan që gjendet në Afrikën veriperëndimore, në bregun e Oqeanit Atlantik. Ky shtet kufizohet nga Algjeria në verilindje, nga Mali në lindje dhe juglindje, nga Senegali në jug, Oqeani Atlantik në perëndim dhe Saharaja Perëndimore në veriperëndim.

Mauritania ka një sipërfaqe prej 1.030.000 km², dhe një popullsi prej 4.763.951 banorësh (Maj, 2021).

Navākshūt, që në gjuhën berbere do të thotë “vendi i erërave”, është kryeqyteti dhe qyteti më i madh i Mauritanisë, dhe shërben edhe si qendra administrative dhe ekonomike e vendit.

GJEOGRAFIA

Mauritania është një vend përgjithësisht i rrafshët, me fusha të gjera e të thata, që thyhen vende-vende nga kreshta dhe dalje shkëmbinsh. Pothuajse tri të katërtat e Mauritanisë janë shkretëtirë, ose gjysmë shkretëtirë. Që nga mesi i viteve 1960, si rezultat i thatësirës së zgjatur, shkretëtira ka ardhur duke u zgjeruar vazhdimisht.

Përballë jugperëndimit të vendit shtrihen një varg shpatesh malore, të cilat i ndajnë fushat e gjera shkretinore në qendër të vendit. Ato shpate malore gjithashtu ndajnë një seri rrafshnaltash ranore, më e larta e të cilave është Rrafshnaltat Adrar, që arrin një lartësi prej 500 metrash mbi nivelin e detit. Në rrëzë të disa prej këtyre shpateve, gjenden oaze që furnizohen me ujë në stinën e pranverës. Mbi rrafshnaltat e Mauritanisë, ngrihen maja të izoluara, shpesh të pasura me minerale. Maja Gilabet Er-Rishat, është një tipar i spikatur i rajonit veri-qendror të Mauritanisë.

Maja Kediet El-Xhil, afër qytetit Zuveira, ka një lartësi prej 915 metrash dhe është maja më e lartë e vendit. Rrafshnaltat gradualisht zbresin në drejtim të verilindjes, deri në djerrishtën El-Xheuf, që është një rajon i gjerë me duna të mëdha rëre, të cilat shkrihen në shkretëtirën e Saharasë. Në perëndim, midis oqeanit dhe pllajave, ndodhen zona të alternuara të fushave argjilore dhe të dunave të rërës, disa

prej të cilave zhvendosen nga vendi në vend, nga erërat e forta dhe lëvizin gradualisht në drejtim të veriut.

Nga lindja në perëndim, shtrihen rripa të bimësisë natyrore, të cilat korrespondojnë me mënyrën se si vijojnë reshjet e shiut, dhe variojnë nga gjurmë të pyjeve tropikale përgjatë lumit Senegal, deri në savana, në juglindje. Në qendër dhe në veri të vendit gjendet vetëm shkretëtirë ranore. Mauritania është vendi i shtatë rajoneve ekologjike: Savana e Akacias Saheliane, Savana e Sudanit Perëndimor, Halofitet (bimë që rriten në toka të kripura) Sahariane, Shkretëtira e Bregut të Atlantikut, stepat dhe pyjet e Saharasë Veriore, stepat dhe pyjet e Saharasë Jugore, dhe pyjet e thata malore të Saharasë Perëndimore.

KLIMA

Mauritania ndodhet në veri të ekuatorit, ku shiu është i pakët dhe temperaturat janë të larta. Klima është përgjithësisht shkretinore, e nxehtë dhe e thatë në shumicën e muajve të vitit. Në verë, temperaturat nganjëherë arrijnë 27 - 42°C, sidomos në zonat larg detit. Përrashtim bëjnë periudha të caktuara, kur Rryma Kanari, që vjen nga veriperëndimi, ndikon në uljen e temperaturave në mbrëmje dhe gjatë natës, veçanërisht në zonat në kufi me Oqeanin Atlantik. Rajonet jugore dhe juglindore të Mauritanisë kanë një klimë tropikale, të nxehtë dhe me shi në verë (300-400 mm), dhe të ngrohtë e të thatë në dimër, ku temperaturat variojnë 12 - 28 °C.

Në veri, ku përfshihen rajonet Inshiri, Adrar dhe Tirs, gjithashtu edhe në pjesët veriore të rajonit të Tagant-it dhe të Houd Esh-Sharkí, moti është kryesisht shkretinor, i thatë, me temperatura të larta në verë dhe të ulëta në dimër, përfshirë këtu edhe stuhitë e shumta të rërës dhe shirat e pakta.

EKONOMIA

Pavarësisht se është e pasur me burime natyrore, Mauritania ka një PBB

(Prodhim të Brendshëm Bruto) të ulët. Shumica e popullsisë varet ende nga bujqësia dhe blegtoia për të siguruar jetesën e saj, edhe pse shumica e nomadëve dhe shumë fermerë, në vitet 1970 – 1980, u detyruan të zhvendosen në qytete për shkak të thatësirave të përsëritura. Mauritania ka depozita të mëdha mineralesh hekuri, i cili zë gati 50% të eksporteve totale, si edhe rezerva ari dhe bakri, që po shfrytëzohen nga kompanitë e minierave.

Nafta në Mauritania u zbulua në vitin 2001, në fushën e Shinkit-it, megjithëse tregohet një ndikim i vogël ekonomik i saj për Mauritaninë.

Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe, ka instaluar impiante të reja



diellore në qytetin e gjelbër pilot Masdar, të cilat furnizojnë me 16.6 megavat shtesë energji elektrike. Mauritania zë një nga vendet kryesore, për sa i përket tranzicionit global në energjinë e ripërtërishme.

HISTORIA E HERSHME

Mesa duket, zona që sot njihet si Mauritania, nuk ka qenë shkretëtirë që nga kohërat antike. Monumentet e gdhendura në shkëmbinj të gjendur atje, tregojnë forma të ndryshme të mjeteve të përdorura nga njeriu i lashtë, të cilat konfirmojnë se vendi ishte i pasur me ujë, binte shi dhe kishte lumenj që me kalimin e kohës janë tharë si rezultat i ndryshimeve të mëvonshme klimatike. Këto ishin arsyt që njeriu i braktisi ato vise dhe shkoi

drejt lindjes dhe jugut, për në zonat që ishin më shumë pjellore, sepse njerëzit në epokën neolitike mbështeteshin kryesisht tek bujqësia.

Në Epokën e Mesme të Gurit, atje u vendosën fise nga Sudani, që kishin ardhur nga rajonet jugore, nga zonat përgjatë lumit dhe nga zonat qendrore. Më vonë atje u vendosën edhe fise berbere, që degëzoheshin nga fisi i famshëm Sanhaxha, dhe mendohet të kenë ardhur atje në shekullin e tretë të erës sonë. Në mijëvjeçarin e parë të erës sonë, fiset Sanhaxha kontrollonin rrugët tregtare që kalonin andej. Fisi Lemtune kontrollonte rrugët tregtare në perëndim të Mauritanisë së sotme (midis rajoneve të Adrar dhe Tagant), fisi Ikdale në jug (kufijtë e ndikimit të të cilit shtriheshin deri tek lumi i Senegalit), si edhe fisi Mesufe në lindje. Këta tre emra fisesh që përmenden këtu, ekzistojnë akoma edhe sot, me një shtrembërim të lehtë në shqiptimin e tyre, pasi fjala Mesufe u shndërrua në Meshluf, dhe në ditët e sotme këto janë nga fiset më të mëdha të Mauritanisë Lindore.

Fiset Sanhaxha shtrihen deri në Mali dhe në Nigeri, në lindje, dhe për një kohë të gjatë ato kanë kontrolluar rrugët tregtare që kalonin nga Sixhilmase, në veri, e deri në Odagest, në jug. Sipas historianëve, kjo është rrjedha se si janë formuar banorët e parë të Mauritanisë, gjë e cila konfirmohet edhe nga zbulimet arkeologjike të gjendura me bollëk.

KUR HYRI ISLAMI NË MAURITANI?

Islami, për herë të parë u shfaq në Mauritaninë në fillim të vitit 116 Hixhri (734 e.j.), pas luftërave të Habib ibn Ebi Ubejde ibn Ukbe ibn Nafi në Magribin e Largët, që u zhvilluan gjatë periudhës së udhëheqjes së Ubejdullah Ibn El-Habhab, të Kairavanit. Sanhaxhët (banorët vendas) e përqafuan Islamin me këtë rast. Prijësinë e tyre asokohe e kishte fisi Lemtune, që themeluan një mbretëri të madhe, të cilën mbretërit e tyre e trashëguan brez pas brezi dhe të cilët në vazhdimësi zhvilluan luftëra me mbretërit e Sudanit, në jug. Një nga mbretërit e tyre, Jahja Ibn Ibrahim El-Xhedali, ishte themeluesi i parë i atij që njihet si Shteti Almoravid (Shteti i Murabitinëve).

SHTETI ALMORAVID

Gjatë shekullit të pestë dhe të gjashtë të Hixhretit, në rajonin e Magribit Islam, nga një lëvizje



XHAMIA CHINGUETTI, SHEK.13-14

misionare reformiste islame, filloi të krijohej Shteti Almoravid. Fillimet e këtij shteti u bazuan mbi lëvizjen për mbrojtjen e fiseve Sanhaxhe, pas bashkimit të një numri të fiseve të mëdha prej tyre. Ky bashkim u kthye në një mbështetje popullore, e cila nga ana tjetër u kthye në një bashkim ushtarak, që çoi përfundimisht në shfaqjen e një fuqie ekonomike rajonale, pasi këto fise kontrollonin një numër rrugësh tregtare, përveç që karakterizoheshin nga një frymë reformiste islame, që bazohej mbi shkollën islame sunite Malikije.

Emri me të cilin ata e quajtën shtetin e tyre: Shteti i Bashkimit dhe Rregullimit, tregonte për cilësitë që i karakterizonin. Lëvizja e parë ushtarake që ata ndërmorën, ishte ajo drejt fisit Xhadale. Pas bashkimit të pjesës tjetër të fiseve beduine Sanhaxhe përkrah tyre, ata përparuan drejt veriut, për t'u ndeshur me Zinatianët, që kontrollonin linjën tregtare që lidhte Saharanë me Andaluzinë. Marrja nën kontroll e qytetit Sixhilmase nga Almoravidët, në vitin 447 H, përbënte të parin operacion të tyre kryesor ushtarak për unifikimin e Magribit Islam. Kështu, shteti i ri mori në dorë kontrollin e një zone gjeografike që shtrihej nga Oqeani Atlantik në perëndim, në zonat e Shinkitit dhe pellgun e lumit Senegal, në jug, dhe u zgjat drejt lindjes deri në kufi me Perandorinë Kanem. Pastaj u zgjerua drejt veriut, duke depërtuar në malet Atlas, dhe e tejkaloi Mesdheun, duke përfshirë brenda tij pjesë të Gadishullit Iberik, dhe duke marrë kontroll mbi Andaluzinë.

Në fillim të shekullit të pestë të Hixhretit, në Mauritaninë hynë fiset arabe. Pastaj, në shekullin e gjashtë Hixhri, atje u vendosën edhe fiset arabe Benu El-Muakkal, që erdhën nga Egjipti i Epërm, si pjesë e migrimit të famshëm të Gjysmëhënës në vendet e Magribit Arab. Por, këta hasën në kundërshtimin e fortë

të fiseve berbere, të cilat nuk e zgjatën qëndruesën. Feja e njëjtë kontribuoi në heqjen e këtij kundërshtimi nga ana e tyre, pasi Islami kishte ardhur që përpara këtyre arabëve në këtë rajon.

Me kalimin e kohës, të dy grupet, berberët vendas dhe arabët e ardhur, u përzier dhe formuan një etni të harmonizuar, të cilët formuan kështu grupin më të rëndësishëm njerëzor përgjatë gjithë historisë së Mauritanisë, dhe që sot ata përfaqësojnë banorët aktualë të Mauritanisë.

Në fund të shekullit të 19-të, gjatë përpjekjeve të vendeve evropiane për territoret në Afrikë, Mauritania u bë koloni Franceze, e cila e fitoi pavarësinë në vitin 1960.

GJUHA

Gjuha Arabe është gjuha zyrtare në vend, sipas kushtetutës së Mauritanisë, pavarësisht se Frëngjishtja është gjuha mbizotëruese në qarqet qeveritare. Gjuha angleze dhe ajo spanjolle janë pak të përhapura atje.

FEJA

Islami është feja e pothuajse të gjithë Mauritanisë, e afërsisht 100% të banorëve të saj. Ata janë muslimanë sunitë, ku shumica e tyre kanë zgjedhur jurisprudencën sipas shkollës Malikije, kurse doktrina e besimit është ajo e shkollës Esh'arije. Mes qytetarëve Mauritanian nuk ekziston asnjë fe tjetër, megjithëse ka bashkësi të mëdha të krishtere Senegaleze dhe nga Mali, që jetojnë në vend, veçanërisht në qytetet e mëdha, si në kryeqytetin Navakshut. Këta të fundit e praktikojnë lirisht fenë e tyre, në vendet e caktuara për ta.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, teologe


<https://www.worldometers.info>
<https://ar.wikipedia.org>
<https://en.wikipedia.org>
<https://www.britannica.com>

MUAJI I RAMAZANIT NË KËNDVËSHTRIMIN E MYFTIUT MUHAMED SYTARI

Në kuadër të Muajit të Begatë të Ramazanit, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam realizoi takimin online, me temë “Muaji i Ramazanit në jetën e muslimanit”. I ftuar në këtë takim miqësor ishte Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili solli në vëmendje një sërë mirësish që bart në vetvete ky muaj i shenjtë, sidomos përmes agjërimit.

Takimi u çel nga drejtori i AIITC, Dr. Ardian Muhaj, i cili bëri një prezantim të shkurtër të myftiut Sytari dhe rëndësisë së trajtimit të kësaj teme. Të pranishmit e ndoqën me interes ligjëratën e Myftiut Sytari, për të cilin Ramazani është momenti më i mirë për reflektim, pasi gjatë këtij muaji përmirësohen marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe skaliten të besimtari virtutet më të mira, si durimi, mëshira, dashuria për Zotin dhe njeriun, sinqeriteti etj.

Sipas tij, është fakt i pashpjegueshëm, se si gjatë agjërimit rritet prodhimtaria e agjëruesit, ai bëhet më produktiv në punët e tij dhe më i kujdesshëm



në shfrytëzimin e kohës, meritë që i takon vetëm Zotit. Por Imami Muhamed Sytari tërhoqi vëmendjen se agjërimi është një nga momentet më të bukura për besimtarin, ndaj dhe sinqeriteti i tij duhet të jetë në gradat më të larta, të jetë në paqe me veten dhe të tjerët.

Përmes ajeteve kuranore dhe

haditheve profetike, Sytari solli një tjetër këndvështrim të Ramazanit, duke e bërë më të dashur për të pranishmit rëndësinë e këtij muaji. AIITC do të organizojë edhe takime të tjera online mbi rëndësinë dhe vlerat e Muajit të Ramazanit.

www.aiitc.net

MYFTINIA NDIHMON SHOQATËN E TË VERBËRVE

Paraditen e të xhumasë, më 7 maj 2021, në kuadër të muajit të madhëruar të Ramazanit si dhe në prag të Natës së Madhe të Kadrit, Myftinia Shkodër organizoi shpërndarjen e radhës së ndihmave, pikërisht 30 pako me ushqime për shoqatën e të verbërve Shkodër.

Përfaqësuesi i Myftinisë, teologu Arben Halluni, i cili mori pjesë në këtë organizim në një prononcim mediatik tha se: “Myftinia Shkodër nga fillimi i Ramazanit dhe deri më tani ka shpërndarë rreth 1000 pako me ushqime për familje të ndryshme në nevojë, për skamnorë si dhe për jetimë. Këto ndihma

vijnë në sajë të bashkëpunimit që ka Myftinia Shkodër me partnerët e saja nga Turqia, Arabia Saudite, Kuvajti, ShBA, Zvicra, Italia, etj., si dhe nga individë bamirës të qytetit tonë”, u shpreh ai.

Më tej, teologu Halluni u bëri thirrje biznesmenëve si dhe njerëzve vullnetmirë që në këto pak ditë të Ramazanit që kanë mbetur të afrohen për të ndihmuar shtresat në nevojë në mënyrë që t’ju lehtësohet vështirësia ekonomike si dhe të ndiejnë se nuk janë të vetmuar apo pa shpresë nga institucionet dhe bamirësit, sidomos në këtë muaj të solidaritetit, të humanizmit dhe mirësive.

MYFTINIA ME MBËSHTETJEN E BANKËS UBA NDIHMOJNË 50 FAMILJE NË OMARAJ



Ditën e mërkurë, më 5 maj 2021, Myftinia Shkodër me mbështetjen e Bankës UBA ndihmuan 50 familje në fshatin Omaraj, Njësia Administrative Postribë.

Myftinia Shkodër falënderon bankën UBA për këtë vepër të mirë me rastin e muajit të begatë të Ramazanit.



Duke marrë shkas nga ngjarja e dhimbshme e humbjes së jetës së një fëmije të mitur në fshatin Guri i Zi, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua prindërve me një mesazh nga mimberi i xhamisë së Parrucës, në hytben e fundit të Ramazanit të këtij viti, më 7 maj 2021, ku bëri thirrje që prindërit të kujdesen për fëmijët e tyre dhe t’i mbrojnë ata nga rrjetet sociale dhe programet e pakontrolluara që përhapen çdo ditë nëpërmjet mjeteve televizive, por jo vetëm.

Ai i bëri apel po ashtu familjarëve që të mos i lejojnë fëmijët të përdorin pa kriter internetin, por të bisedojnë dhe të kalojnë kohën e lirë me ta.

“Ky është një alarm për çdo familje. Mos më thoni që ia lëmë celularët në dorë, sepse fëmija është i vogël!

Mos thoni nuk kemi kohë! Janë justifikime të padobishme!

Të kemi kujdes, çfarë hyn në dritaret

MYFTIU I SHKODRËS, APEL PËR PRINDËRIT QË TË KUJDESËN PËR FËMIJËT E TYRE



e vetëdijes së fëmijëve tanë. Të kemi kujdes në duart e kujt i lëmë fëmijët!

Nuk do të analizojmë rastin, sepse nuk është ky momenti. Por, dhimbja

e kësaj humbje të jetë alarm për të gjithë ne, për arsimtarët, edukatorët, prindërit, imamët e prijësit fetarë...”, tha në mes të tjerave Imam Sytari.

SOFRA BUJARE E IFTARIT QË BASHKON SHKODRËN ME PRIZRENIN

Në kuadër të takimeve vëllazërore të Muajit Ramazan dhe në kushtet e situatës që po kalojmë, Myftinia Shkodër organizoi ditën e xhuma, më 7 maj 2021, sofrën vëllazërore të iftarit për nder të Kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, H. Besim Berisha me kolegë.

Në fjalën e rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari falënderoi mysafirët nga Prizreni, sikurse theksoi se përtej kushteve të imponuara nga rregullat në fuqi, kjo sofër na bashkoi sërish, me dëshirën e mirë të ruajtjes së kësaj tradite të bukur, që na bashkon



përherë e më shumë në rrugën e ruajtjes së vlerave më të mira të besimit dhe atyre kombëtare.

Myftiu falënderoi edhe miqtë e ftuar në këtë iftar vëllazëror, si dhe antarët e këshillit të Myftinisë Shkodër, për praninë e tyre në respekt të vëllazërve nga Prizreni.

Nga ana e tij, H. Besim Berisha falënderoi mikpritjen e Myftinisë Shkodër dhe uroi Myftiun për këtë Muaj të begatë dhe mirësitë e tij. Ai theksoi se tradita e bukur e takimeve të shpeshta në Prizren e Shkodër, është një gjurmë më shumë në rrugëtimet e përbashkëta në shërbim të mësimave dhe udhëzimeve islame, si dhe një kontribut i vyer për ata që vijnë.

HATMEJA SHERIFE E RAMAZANIT NË PRAG TË NATËS SË KADRIT

Ditën e shtunë, më 8 maj 2021, pas namazit të iqindisë në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër organizoi përmbylljen e Hatmes Sherife të këtij viti, leximi i së cilës nisi me fillimin e këtij Ramazani, si një traditë shekullore në qytetin e Shkodrës.

Besimtarë të moshave të ndryshme kishin ardhur për të marrë pjesë në këtë ceremoni, si dëshmi e përkushtimit ndaj Kuranit Famëllartë dhe mesazheve të ruajtjes dhe mësimi të tij ndër breza.

Ceremonia nisi me faljen e namazit të iqindisë, nën drejtimin e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili



i priu besimtarëve edhe në leximi e xhyzit të 30- të dhe të fundit nga Kurani Famëllartë, në mexhlin e Hatmes Sherife.

Myftiu, së bashku me imamët e nderuar dhe hafizët e ardhur nga Turqia, udhëhoqën besimtarët në këtë përmbyllje plot emocione të leximit të plotë të Fjalës së Allahut, duke marrë e dhënë mirësi e dritë, nga mirësia dhe drita e Kuranit i Madhërishëm.

Ceremonia u përmbyll me duanë e bërë nga Myftiu i Shkodrës, në të cilën u lut për pranimin e kësaj Hatmeje Sherife, për agjërimin e Ramazanit dhe mirëqenien e besimtarëve.

Myftinia Shkodër falënderon përkushtimin e imamëve të nderuar dhe besimtarëve të dashur, që me besnikëri e përkushtim, morën pjesë çdo ditë në këtë aktivitet të spikatur e tradicional në këtë Muaj të Begatë!

NATA E KADRIT MBLEDH BESIMTARËT NË XHAMITË E SHKODRËS

Mbrëmjen e së shtunës, më 8 maj 2021, me afrimin e kohës së jacisë, besimtarë të shumtë u drejtuan nga xhamitë e qytetit, për të marrë pjesë në lutjet dhe adhurimet e Natës së Kadrin, me shpresën e pranimit.

Nga xhamia e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua besimtarëve me një mesazh, ku kërkoi që përkushtimi i krejt këtij muaji të begatë, të vazhdojë deri në momentin e fundit të tij.

Myftiu tha se në mbarë botën islame, besimtarët e mbështetur në hadithe e komentet e ndryshme, në veprën e sahabëve dhe transmetimet e tyre, i japin një rëndësi më të veçantë natës së 27-të të çdo Ramazani, me shpresën dhe lutjet që kjo të jetë Nata e Kadrin.

Myftiu kërkoi që të bëhen lutje dhe dhikre, edhe pas daljes nga xhamia, deri në agimin e diellit të ditës së re.

Së bashku me imamët e xhamisë së Parrucës dhe dy hafizët e ardhur nga Turqia, ai drejtoi namazet e kësaj nate, sikurse drejtoi lutjen e kësaj Nate, i shoqëruar nga amin-at e të rinjve të shumtë në xhami.



Në kuadër të aktiviteteve dhe adhurimeve të Natës së Kadrin, Myftinia Shkodër ka udhëzuar dhe fton besimtarët që lutjet e këtyre ditëve dhe netëve të begata të jenë edhe për Palestinën martire dhe qëndrestarët besnikë të shenjtërive të mbarë ymetit!

Ditën e djeshme, më 8 maj 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i përkushtoi një lutje të veçantë vëllezërve tanë në Palestinë e Kudsi Sherifë, që në këto net të shenjtë, po përballen me arrogancën dhe mizoritë e makinerive të dhunës dhe terrorit, që ushtrohen në mënyrë sistematike ndaj atij populli dhe shenjtërive prej dekadash.

Lutje për Palestinën dhe Kudsi Sherifin u bënë edhe gjatë natës, ku besimtarët iu drejtuan Allahut të Madhëruar që paqja dhe drejtësia të mbulojë atë vend dhe mbarë botën, sikurse u lutën për mirëqenien e mbarë muslimanëve të botës dhe rizgjimën e tyre për t'u kthyer tek lavdia e shekujve dhe krenaria legjitime!

NATA E KADRIT, LUTJE E POSAÇME PËR PALESTINËN MARTIRE



MYFTIU FALËNDEROI IMAMËT NË IFTARIN E PËRBASHKËT



Të dielën, më 9 maj 2021, Myftinia Shkodër organizoi iftarin tradicional me imamët e saj.

Në fjalën e rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, uroi imamët për punën dhe përkushtimin e tyre dhe theksoi se tubimi i kësaj mbrëmje i ngjan një familjeje, ku çdo anëtar e di vendin e tij dhe përkushtohet për të ruajtur tabanin dhe genin e saj!

Myftiu tha se përgjegjësia e imamëve është e madhe, sidomos në raport me ruajtjen e harmonisë dhe mosprishjen

e tabanit dhe traditave që bashkojnë muslimanët.

Ai shprehu falënderimet e tij për ta dhe u lut që të kenë përherë mbarësi dhe suksese në jetë dhe aktivitet!

Iftari u përshëndet edhe nga drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, i cili falënderoi Myftiun dhe imamët për përkushtimin për të ftuar familjet muslimane të Shkodrës, që fëmijët e tyre të zgjedhin medresenë për edukimin dhe ndjekjen e mësimave të tyre.

NDIHMA USHQIMORE PËR PERSONAT PARA-TETRAPLEGJIKË



Ditën e martë, më 11 maj 2021, Myftinia Shkodër me mbështetjen e Halping Hand For Relief And Development-USA, me rastin e muajit të Begatë të Ramazanit, shpërndanë 40 pako ushqimore për personat para-tetraplegjikë.

Drejtuesi i Shoqatës së Para-Tetraplegjikëve, z. Saimir Beqiri falënderoi Myftininë Shkodër për bashkëpunimin e vazhdueshëm, duke qenë pranë këtyre njerëzve dhe familjeve të tyre.



MYFTINIA SHKODËR DHE FONDACIONI "MIRËNJOHJE" NDIHMOJNË 300 FAMILJE



Ditën e mërkurë, më 12 maj 2021, Myftinia Shkodër me mbështetjen e fondacionit "Mirënjohja" shpërndanë 300 pako ushqimore me rastin e muajit të Bekuar të Ramazanit dhe në prag të festës së Fitër Bajramit.

Nga ky kontingjent me 300 pako ushqimore, 150 prej tyre u shpërndanë për familjet e lagjes Liria dhe Ura e Bunës, ndërsa të tjerat për familje të tjera të zonës Shkodër.

Myftinia Shkodër falënderon donatorët bujarë për këtë ndihmë me vlerë në prag të festës së Fitër Bajramit.



HAFIZ HAVZI RAMADANI NGA TETOVA SHPALLET FITUES I GARAVE NË HIFZ TË KUR'ANIT TË ORGANIZUARA NGA XHAMIA WIL NË ZVICËR

Në garat Kur'anore që u mbajtën online nën organizimin e Xhamisë së qytetit Will të Zvicrës, nën koordinimin dhe moderimin e imamit të xhamisë, Mr. Bekim ef. Alimi, vendi i parë i takoi hafizit të mirënjohur nga Tetova, Hfz. Havzi ef. Ramadani, i cili triumfoi duke marrë maksimumin e 150 pikëve. Kështu ai u shpall hafizi më i mirë në kategorinë e memorizimit të tërë Kur'anit Famëlartë.

Në garë morën pjesë hafizë të shumtë nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Kosova. Vlen të theksohet se të gjithë dëshmuar për vlerat e tyre dhe kujdesin që ia kushtojnë ruajtjes së Kur'anit Famëlartë.

Bashkësia Fetare Islame e RMV uron hafiz Havziun për suksesin dhe të gjithë garuesit tjerë, duke lutur All-llahun

MYFTIU PRITI KRYETARIN E KOMUNITETIT MYSLIMAN SHQIPTAR TË ARIZONËS



Ditën e martë, më 18 maj 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në zyrën e Myftinisë Shkodër, të nderuarin Imam Didmar Faja, kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar të Arizonës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i cili ndodhet për një vizitë në vendlindjen e tij, Shkodër.

Pasi i uroj mirëseardhjen Imam Fajës në qytetin e Shkodrës, Myftiu e njohu me veprimtaritë e ndryshme të Myftinisë në këtë periudhë, sidomos gjatë muajit të begatë të Ramazanit që sapo kaloi.

Myftiu Sytari vlerësoi gjurmët e Imam Didmar Fajës në ShBA dhe Meksikë dhe numrin në rritje të të konvertuarve në Islam nga këto vende, që sipas tij janë sihariq i mirë, që na gëzon pa masë dhe

na vërteton ditë pas dite se ky shekull, është shekulli i Islamit.

Ndërsa, kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar të Arizonës e njohu Myftiun e Shkodrës për aktivitetet dhe misionin fisnik të institucionit që ai drejton në Arizona, sidomos në përhapjen dhe përçimin e Islamit tek brezat e ndryshëm, sidomos tek të rinjtë amerikanë.

Të dy titullarët diskutuan edhe për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimeve në mes dy institucioneve përmes aktiviteteve kulturore, arsimore, shkëmbimit të eksperiencave, si dhe shërbimet ndaj Thirrjes Islame dhe domosdoshmërinë e koordinimit të faktorit musliman shqiptar, kudo nëpër botë.



Fuqiplotë t'i shpërblejë me shpërblimet e tija të pakufishme.

Mirënjohje e veçantë shkon edhe për anëtarët e komisionit vlerësues: Dr. Selver ef. Xhemali - drejtor për diasporë pranë BFI të RMV, H. Muhamed ef. Sytari - mufti i zonës Shkodër dhe H. Egzon ef. Ibrahim - lexues i mirënjohur i Kur'anit, si dhe për Këshillin e xhamisë në Will dhe koordinatoren e organizimit, imamin e Xhamisë në Will, Mr. Bekim ef. Alimi.

MEJTEPI I IM... XHAMIA E LAGJES KIRAS

PAK HISTORI:

- Xhamia Kiras, ndodhet në një prej lagjeve të vjetra të qytetit të Shkodrës.

- Përbëhet prej familjeve autoktonë dhe të ardhur. Familjet më të njohura janë: Kraja, Pirani, Dautovi, Bregu, Mustafa, Stankaj, Buliqi, Bashaj, Alivoda, Cani, Shpuza, etj.

- Me rilejimin e besimeve fetare në Shqipëri, pas vitit 1990 me iniciativën e besimtarëve dhe kontributin e të gjithë banorëve të lagjes godina e xhamisë u rimuar, pasi në kohën e sistemit monist u përdor për zyra shtetërore.

- Në vitin 1995 me financim nga Shteti i Kuvajtit u ndërtua xhamia e re, pikërisht në tokën vakëf të saj, disa metra larg xhamisë së vjetër.



- Ndërsa në nëntor të vitit 2020, u rindërtua xhamia e re me dy minare, përsëri përmes donatorëve nga Shteti i Kuvajtit..

- Në xhaminë e Kirasit nga viti 1990 e deri më sot kanë shërbyer imam dhe mësues të mejtepeve: Hafiz Sulejman Kraja, Xhavid Sokoli, Ndrim Sulejmani, Dritan Rrahmani, Ylli Buraniqu, dhe imamët aktual: Ruzhdi Plangaj dhe Altin Nikshiqi.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 19 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2021 është mbi 500 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, në vazhden e vizitave dhe takimeve të me nxënësit e xhamive që frekuentojnë rregullisht kurset-mejtepë e mësim-besimit, më 23 maj 2021 drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi takimin e radhës me nxënësit e kursit fetar në xhaminë Kiras.

Teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga imamët Ruzhdi Plangaj dhe Altin Nikshiqi, të cilët mirëmbajnë këto veprimtari mjaft të rëndësishme edukative dhe arsimore.



NJË PASDITE E BEGATË VLERASH BESIMI DHE VËLLAZËRIE ISLAME E KOMBËTARE

Sfidat dhe arritjet e muslimanëve shqiptarë në perëndim, ishin në fokusin e aktivitetit, që Myftinia Shkodër zhvilloi ditën e xhuma, më 21 maj 2021, në bahçen e xhamisë së Fushë Çelës.

Të ftuar për të sjellë eksperiencat dhe vizionet e tyre në këtë tubim, ishin edhe Imam Bekim Alimi, kryetar i Federatës Muslimane në Zvicrën Lindore, njëkohësisht imam dhe ligjërues në xhaminë e Wilit, si dhe Imam Didmar Faja, kryetar i Komunitetit Musliman Shqiptar në Arizona, si dhe imam i



Qendrës së Bashkuar Islame në Arizona.

Në fjalën e hapjes, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vlerësoi faktin se shqiptarët sot, gjithandej nëpër botë janë misionarë të zellshëm e të spikatur në përhapjen e dritës së fesë islame. Ai tha se fakti që Islami u përqaftua masivisht nga shqiptarët, është një shenjë e madhe për të vazhduar me përkushtim shërbimet ndaj fesë së Allahut, përtej taborrave të islamofobëve, që përtej çdo përpjekjeje, nuk mund ta mbulojnë diellin që na sjell

dritë të gjithëve.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga nënkryetari i Bashkisë Shkodër, z. Ardit Qylybyli, i cili ishte i pranishëm në këtë tubim vlerash.

Ndërkohë ligjëruesit e nderuar sollën në vëmendje të ftuarve realitete nga aktiviteti islam në Zvicër dhe Amerikë, si dhe disa nga sfidat dhe arritjet e tyre në këto vende.

U theksua me të madhe fakti se përtej përballjeve me fanatizmin, racizmin dhe

tendencat e ndryshme, kryesisht politike, Islami dhe muslimanët vazhdojnë të rrezatojnë vlerat e tyre kudo nëpër botë, duke dëshmuar përhapjen e mesazheve që e afrojnë përherë e më shumë njeriun me vëllanë e tij njeri.

Konvertimet e shumta në Islam dhe rritja e numrit të studiuesve dhe intelektualëve të shquar që e përqafojnë Islamin gjithandej nëpër botë, mbetet një shenjë shprese dhe optimizmi për më të mirën e njeriut, kudo në botë.

Aktiviteti u zbukurua edhe me praninë e bylbylit të trevave shqiptare, Hfz. Egzon Ibrahim, i cili dhuroi emocione e gëzim me pjesët e përzgjedhura nga Kurani Famëllartë dhe ilahitë e ndjera.

Një fjalë e ndjerë ishte edhe ajo e mbajtur nga Dr. Xhemal Seferti, nga Jordania, i cili solli në vëmendje hakun e Kudsi Sherifit, si dhe faktin se ajo xhami dhe tokë e shenjtë ishte, është dhe do të jetë njësi matëse e lartësisimit të burrave të mëdhenj të ymetit islam.

Të pranishëm në këtë tubim ishin edhe drejtues të medresesë, shoqatave, fondacioneve, imamë, teologë dhe intelektualë nga Tirana, Tuzi, Ulqini, Tetova e Prizreni.



BASHKËBISEDIM TELEVIZIV “SFIDAT E MUSLIMANËVE SHQIPTARË NË PERËNDIM”

Mbrëmjen e të martës, më 25.05.2021, në Tv Star Plus, të ftuarit e gazetarit Erzen Koperaj, në emisionin “Tonigh” ishin Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër, Imam Bekim Alimi, kryetar i Federatës Muslimane në Zvicrën Lindore si dhe Imam Ditmar Faja, kryetar i Komunitetit Musliman Shqiptar në Arizona dhe imam i Unitet Islamic Center of Arizona, të ShBA-së, të cilët trajtuan së bashku tematikën “Sfidat e muslimanëve shqiptarë në Perëndim”.

mes të besimtarëve ku ata shërbejnë, por edhe për rolin e çmuar në ruajtjen dhe kultivimin e ndjenjës fetare dhe kombëtare të brezat e rinj shqiptar dhe më tej...

Ndërsa, të ftuarit e nderuar, imam Alimi dhe imam Faja gjatë këtij bashkëbisedimi të këndshëm, e cila është përcjellë edhe në rrjetet dhe platformat sociale sollën tek teleshikuesit realitetet nga aktivitetet e tyre të dobishme islame në Zvicër dhe në Arizona të Shteteve të Bashkuara, si dhe disa nga sfidat dhe



Fillimisht, Myftiu shprehu kënaqësinë për vizitën e imamëve të nderuar nga Zvicra dhe ShBA, të cilët me vizitën e tyre në Shkodër kanë ndryshuar atmosferën e fetare dhe jo vetëm, ku përmes aktiviteteve të ndryshme të organizuar nga Myftinia me pjesëmarrjen e tyre, siç është edhe ky emision televiziv, kanë sjellë konkretisht eksperiencat dhe vizionet e tyre, sidat dhe arritjet në drejtin të thirrjes së shenjtë islame në

arritjet e tyre në këto vende, të cilët përhapin në mënyrën më të mirë të mundshme Fjalën e Zotit dhe besimin islam.

Gjatë këtij emisioni ata treguan edhe për marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunuese që kanë me klerikët e besimeve të tjera fetare, të cilët së bashku kontribuojnë përmes takimeve dhe veprimtarive në ruajtjen e vlerave të përbashkëta njerëzore.



KRIMET E KOMUNIZMIT DHE NËPËRKËMBJA E TË PËRNDJEKURVE..!



Krimet e komunizmit dhe nëpërkëmbja e të përndjekurve të asaj kohe akoma sot, pas tre dekadash, mbeten dy njolla shëmtuese në hartën e zhvillimeve të historisë sonë kombëtare dhe dinjitetit njerëzor!

Mosdënimi i krimeve të komunizmit dhe kalimi hutimthi në një realitet tranzicional, në krejt dimensionet e tij dhe përgjatë krejt këtyre viteve të gjata, ngjet më shumë me një axhendë shpërbërëse të kombit, identitetit dhe dinjitetit të tij, sesa një pakujdesi në një rugëtim të mirëkopsitur!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari

Shkodër, 28 maj 2021

* Fotot, nga aktiviteti i sotëm zhvilluar në Muzeun Historik të Shkodrës, nga Autoriteti Për Informimin Mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, NË KUADËR TË PROJEKTIT ICMP-AIDSSH “RRITJA E NDRËGJEGJËSIMIT TË PUBLIKUT PËR DREJTËSINË TRANZITORE DHE PAJTUESE: ADRESIMI I ÇËSHTJES SË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË PERIUDHËS KOMUNISTE” - AKTIVITET PËRKUJTIMOR DHE PREZANTUES I UDHËZUESIT PËR FAMILJARËT E TË ZHDUKURVE, DËSHMIVE DHE EKSPOZITËS.

(Marrë nganga profili i facebook-ut - MS)





Kudsi Sherif

TOKA E SHENJTË E PROFETËVE TË ZOTIT!

"Do të vijë një kohë, kur njeriu të shpresojë të ketë, qoftë edhe një pëllëmbë tokë, nga ku të shikojë Bejtul-Makdis (Xhaminë Aksa), e të jetë më e mirë për të, se sa dynjaja dhe çka ka në të!" - Hz. Pejgamberi (a.s)

**TË JESH NË KRAH TË POPULLIT PALESTINEZ
ËSHTË HUMANIZËM!**

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org